



**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 5, datë 15.04.2021

PËR

**MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
HIMARË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 2, DATË 16.10.2017, TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË TERRITORIT, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr.686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar si dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 2, datë 16.10.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Himarë”, Vendimit Nr. 5, datë 10.06.2020 të KKT-së “Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Himarë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.18, datë 30.03.2021 Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Himarë të miratuar me Vendimin Nr. 2, datë 16.10.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 5, datë 10.06.2020, të bëhen ndryshime në dokumentin e Rregullores së Planit:

- “Tabelat e Treguesve të Zhvillimit”

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Himarë, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Himarë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Himarë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
I PLANIT**

**KRYETARI
I PLANIT**

**KRYETARI
I PLANIT**

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASHTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

